# DËSHMI ARKIVI

**A-443514**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rutte: KFOR-i do të vijojë të jetë në Kosovë, pavarësisht aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/rutte-kfor-i-do-te-vijoje-te-jete-ne-kosove-pavaresisht-aktgjykimit-ndaj-ish-krereve-te-uck-se/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 14:52:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 14:48:08 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 9c827bd06223425f480e9719e618b3d38fd29d64b88ffea4e1582e1503f24298 |
| TEKSTI | f3a988954b3b7ed07ef2e2d809c016cc0fcd44f5056ee850a6459d363ed142ea |
| PAMJA | e606bef7c83f9a38ef39a4ddcb89a1a89374e6617e174c3bcabdd02a84bb8448 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 30455c9675bb816ce5d8261cf2201c33a09054f5f596615517ed9dcf28f8d507 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | e0b9829abbee6aeaf0cbfff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67fff94e9a06c82fe2c5 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/30455c9675bb816ce5d8261cf2201c33a09054f5f596615517ed9dcf28f8d507`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT

# Rutte: KFOR-i do të vijojë të jetë në Kosovë, pavarësisht aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

14 Shtator 2026 | 16:48

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka deklaruar se KFOR-i do të vazhdojë të jetë i pranishëm në Kosovë dhe të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit dhe paqes, pavarësisht zhvillimeve që mund të pasojnë shpalljen e aktgjykimit ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë.

Duke iu përgjigjur një pyetjeje të një gazetari të agjencisë ndërkombëtare të lajmeve Reuters lidhur me situatën në Kosovë dhe aktgjykimin që pritet të shpallet të mërkurën ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, Rutte tha se KFOR-i "është aty", pavarësisht lajmeve që mund të vijnë.

"KFOR-i është aty për t'u siguruar që NATO-ja të vazhdojë të kontribuojë në stabilitet dhe paqe", u shpreh Rutte.

Ai theksoi se prania e NATO-s në Kosovë ka krijuar prej më shumë se dy dekadash një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm për qytetarët. Dhe kjo vlen edhe sot, pavarësisht se çfarë lajmesh mund të vijnë këtë javë ose në periudhën e ardhshme", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

Rutte nënvizoi gjithashtu se angazhimi i Aleancës për paqen dhe sigurinë në Kosovë është afatgjatë dhe do të vijojë.

Sipas tij, NATO-ja do të vazhdojë të vlerësojë se cili është konfigurimi më i përshtatshëm i KFOR-it dhe se si misioni mund të përshtatet me situatën konkrete në Kosovë.

"Kjo nënkupton vlerësimin e vazhdueshëm se cili është konfigurimi më i mirë i KFOR-it dhe se si mund të përshtatet më së miri me situatën konkrete", deklaroi Rutte, duke shtuar se zhvillimet në Kosovë kanë ndikim edhe në stabilitetin e të gjithë rajonit.

Aktgjykimi ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së pritet të shpallet të mërkurën, më 16 shtator, nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

Shiko në:

LAJMI I FUNDIT

16:39 Frikë nga zhvillimi i pakontrolluar i Inteligjencës Artificiale, bien aksionet në bursa

16:33 Elbasani "thyen" Egnatian, Gvozdenoviç dhe tre lojtarë në formacionin e javës

16:24 Nafta 108 dollarë/fuçia, rritet presioni për çmimin mbi 220 lekë në Shqipëri

15:58 Gazetari Osman Stafa kallëzon në polici mesazhin kërcënues, nisin hetimet

15:47 100 milionë euro klauzolë, Barcelona blindon talentin spanjoll

15:39 Skocia, Uellsi dhe Irlanda e Veriut kërkojnë shkëputje nga Britania dhe rikthim në BE

TESTIM

## LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | RAJONI

### “Liri për çlirimtarët”, nesër marshim në Shkup në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

Forumi Rinor Shqiptar përmes një postimi kanë njoftuar se të martën më 15 shtator do të organizohet një marshim në Shkup në mbështetje të ish-krerëve...

13:35 | 14/09/2026

KOSOVË | RAJONI

### Demonstrata më 16 shtator në Kosovë, Ambasada amerikane: Shmangni zonat me grumbullime të mëdha

Ambasada e SHBA-së në Prishtinë ka dalë këtë të hënë me një njoftim lidhur me demonstratën që pritet të zhvillohet të mërkurën më datë 16...

11:20 | 14/09/2026

KOSOVË | RAJONI

### Zgjedhja e presidentit, Kurti: Jemi shumë afër marrëveshjes, zgjedhjet e reja do të ishin papërgjegjësi

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë thirrje për zgjidhjen e çështjes së presidentit, duke thënë se vendi është shumë afër një marrëveshjeje politike dhe...

11:19 | 14/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.